



NJOFTIM

Për mbajtjen e takimeve publike me qytetarë me banorë të fshatrave: **Dejnë, Vrajak dhe Bratotin.**

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, kryetari i Komunës, Smajl Latifi organizon takime publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve në këto fshatra: **Dejnë, Vrajak dhe Bratotin.**

Duke e pasur parasysh përkushtimin për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi përdor mekanizma të këshillimeve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në takime, për vlerësimet dhe propozimet për çështje të interesit të tyre.

Duke qenë pjesë e këtyre takimeve, ftojmë qytetarët të japin kontributin e tyre!

Tema e takimeve: Kërkesat e tyre dhe ecuria e projekteve për vitin 2022.

Takimet mbahen në:

1	Dejnë	Objekti SHFMU “Rudolf Walter”	23.5.2022	18:00
2	Vrajak	Objekti SHFMU “Tre Dëshmorët”	23.5.2022	20:00
3	Bratotin	Objekti SHFMU “Tre Dëshmorët”	23.5.2022	20:00

Jeni të mirëpritur!